

PSH. nr. 154/20

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, në përbërje prej: z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, si dhe duke u bazuar në nenin 99 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës dhe konform nenit 32 të Rregullores së punës së OSHP-së nr. 83/20, pas shqyrtimit të kërkesës së AK- Komuna e Gjakovë (KK Gjakovë) nr. 154/20, kërkesë për zbatim të nenit 99.2 LPP-së, ndaj OE: “D & T Group” shpk, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Mirëmbajtja e autorrugëve, pjesa I - Mirëmbajtja e rrugëve urbane” me numër të prokurimit: 632-19-7809-211, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – Komuna e Gjakovës, më: 03.09.2020 mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar, kërkesa e Autoritetit Kontraktues /AK/ - Komuna e Gjakovës nr. 154/20, për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurimin publik të OE “D & T Group” shpk lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja e autorrugëve, pjesa I- Mirëmbajtja e rrugëve urbane” me numër të prokurimit: 632-19-7809-211.

A R S Y E T I M

Organi Shqyrtues i Prokurimit, më dt. 14 maj 2020, ka pranuar nga autoriteti kontraktues – Komuna e Gjakovës, parashtresën me nr. të protokollit 154/20, përmes së cilës autoriteti kontraktues paraqet kërkesë për marrjen eventuale të masave sipas nenit 99.2 të LPP-së, për OE “D & T Group” shpk lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Mirëmbajtja e autorrugëve, pjesa I- Mirëmbajtja e rrugëve urbane” me numër të prokurimit: 632-19-7809-211.

Organi Shqyrtues i Prokurimit me dt. 19.05.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të përgatitur një kronologji për panelin shqyrtues lidhur me kërkesën e dt. 19 maj 2020, të parashtuar nga Autoriteti Kontraktues – Komuna e Gjakovës.

AK-ja, në kërkesën e cekur si me lart si arsye për marrjen e masave ndaj OE "D & T Group" shpk, për të dhëna të rrejshme, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Mirëmbajtja e autorrugëve, pjesa I- Mirëmbajtja e rrugëve urbane" me numër të prokurimit: 632-19-7809-211, sipas arsyeve si në vijim:

Eksperti shqyrtues ka sqaruar se Autoriteti Kontraktues – Komuna e Gjakovës, në kërkesën e datës 14 maj 2020, kërkon marrjen e masave eventuale ndaj OE "D & T Group" shpk, konkretisht kërkon që ky operator ekonomik të futet në liste të zezë në kohë të pacaktuar për shkak se i njëjti ka paraqitur të dhëna të rreme, duke kontrata si shtim material, konkretisht eksperti shqyrtues ka sqaruar se AK ka deklaruar se kanë kërkuar nga OE informata shtesë konform nenit 72 të LPP-së dhe se pas dëshmive të dorëzuar nga OE konform nenit 72 është konstatuar se:

1. Kontrata e lidhur në mes të SHPK "Noti Beton" & "Inova shpk & D& T group" përkatësisht neni 2 i saj tregon se palët janë dakorduar për ndertim të kolektorit të betonarme dhe kanalizimi fekal në rrugën mbi lumin Prishtina. Ky aktivitet kërkon që operatori të ketë eksperiencë në mirëmbajtje të rrugëve e që operatori ekonomik nuk ka ofruar dëshmi që gjatë implementimit të kësaj kontrate ka kryer punë të tilla.

2. Referenca dhe kontrata e lidhur në mes të Ministrisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe D&T Group nuk ka asnjë dëshmi që i njëjti ka kryer punë në mirëmbajtje të rrugëve apo hapsirave publike. Ka ofruar vetëm një deklaratë me shkrim në të cilën pohon se ka kryer punë në kthimin e gjendjes së meparshme të rrugëve, mirëpo deklarin nuk e ka mbështetur në dëshmi sic janë pozicionet e paramases në kontratë.

3. Në kontratën me numër 02/410/04-30828 të datës 08 nëntor 2018 "Sanimi dhe ndertimi i pendave të kanaleve të ujitjes" të komunes së Gjakovës nuk ka asnjë pozicion të mirëmbajtjes së rrugëve, në sqarime Operatori Ekonomik ka bashkangjitur referencën e cila është lëshuar pas datës së mbylljes së aplikimit për këtë tender 05. 11. 2019, përkatësisht referencat janë të datës 07. 02. 2020 dhe 02. 03. 2020.

4. Kemi të bëjme me ndryshim material, pra në sqarime është sjellë kontratë me datë tjetër nga ajo që është dorëzuar në e-prokurim, për këtë OE ka deklaruar se ka bërë një lëshim por nëse e analizojmë këtë kontratë pika e parë e marrëveshjes se OE që ka me "Florida" shpk është që të kryej të gjitha shërbimet e pastrimit të rrugëve nga bora kurse OE në fjalë nuk ka asnjë dëshmi që posedon makineri për kryejn e punëve të tilla, si ka mundësi atëherë që ka kryer punë në vlerë prej 205, 000. 000 euro.

5. Se kanë bashkangjitur një kontratë me titull "Mirëmbajtja rutinë e rruëgeve dimërore Rruga e Bujanit -

Qafë Morinë, Spot, Kërnajë, Mejadan, Tropojë- Bucaj 30. 76 km". Kjo kontratë prapë është shtim material sepse nuk rezulton në listën që operatori ekonomik e ka dorëzuar në e-prokurim.

AK ka deklaruar se: "nisur nga ato më lartë ne si AK dyshojmë se operatori ekonomik "D&T Group" shpk ka dorëzuar dokumente të falsifikuara, prandaj kërkojmë nga ju (OSHP) që ti shqyrtoni faktet tona dhe OE të lartpërmendur ta fusni në listën e zezë për prezantim të dokumenteve të falsifikuara.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 03.09.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: kërkesa e AK-së, dokumentacioni i lëndës, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të kërkesës së autoritetit kontraktues dhe arsyeshmërisë së dhënë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi konstaton se autoriteti kontraktues – Komuna e Gjakovës, nuk ka dorëzuar asnjë provë që dëshmon se OE "D & T Group" shpk-Gjakovë ka mashtruar apo ka falsifikuar ndonjë dokument apo dëshmi, për të cilën edhe OSHP, mund të merr masa konkrete ndaj ndonjë operatori ekonomik.

AK kërkesën e saj për OE "D & T Group" shpk e ka bazuar në atë se i njëjti ka paraqitur të dhëna të rreme, duke ofruar dokumente dhe deklarata jo të sakta, konkretisht Operatori ekonomik "D & T Group" shpk, për kontratën e lidhur në mes të SHPK "Noti Beton" & "Inova shpk & D& T group" përkatësisht neni 2 i saj tregon se palët janë dakorduar për ndertim të kolektorit të betonarme dhe kanalizimi fekal në rrugën mbi lumin Prishtina, ndërsa aktiviteti i prokurimit për të cilën është parashtruar kërkesa kërkon që operatori të ketë eksperiencë në mirëmbajtje të rrugëve e që operatori ekonomik nuk ka ofruar dëshmi që gjatë implementimit të kësaj kontrate ka kryer punë të tilla.

AK poashtu ka theksuar se Referenca dhe kontrata e lidhur në mes të Ministrisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe D&T Group nuk ka asnjë dëshmi që i njëjti ka kryer punë në mirëmbajtje të rrugëve apo hapsirave publike. Sipas AK-së, OE ka ofruar vetëm një deklaratë me shkrim në të cilën pohon se ka kryer punë në kthimin e gjendjes së meparshme të rrugëve, mirëpo deklarin nuk e ka mbështetur në dëshmi sic janë pozicionet e paramases në kontratë.

AK poashtu ka kërkuar të merret masa ndaj OE edhe për kontratën me numër 02/410/04-30828 të datës 08 nëntor 2018 "Sanimi dhe ndertimi i pendave të kanaleve të ujitjes" të Komunes së Gjakovës nuk ka asnjë

pozicion te mirëmbajtjes së rrugëve, në sqarime Operatori Ekonomik ka bashkangjitur referencen e cila është lëshuar pas datës së mbylljes së aplikimit për këtë tender 05. 11. 2019, përkatësisht referencat janë të datës 07. 02. 2020 dhe 02. 03. 2020.

AK ka theksuar se kemi të bëjmë me ndryshim material, pra në sqarime është sjellë kontratë me datë tjetër nga ajo që është dorëzuar në e-prokurim, për këtë OE ka deklaruar se ka bërë një lëshim por nëse e analizojmë këtë kontratë pika e parë e marrëveshjes se OE që ka me "Florida" shpk është që të kryej të gjitha shërbimet e pastrimit të rrugëve nga bora kurse OE në fjalë nuk ka asnjë dëshmi që posedon makineri për kryejn e punëve të tilla, si ka mundësi atëherë që ka kryer punë në vlerë prej 205,000.00 euro.

AK ka kërkuar të merren masa ndaj OE sepse sipas tyre OE në fjalë kanë bashkangjitur një kontratë me titull "Mirëmbajtja rutinë e rrugëve dimërore Rruga e Bujanit - Qafë Morinë, Spot, Kërnajë, Mejadan, Tropojë-Bucaj 30.76 km", duke theksuar se kjo kontratë prapë është shtim material sepse nuk rezulton në listën që operatori ekonomik e ka dorëzuar në e-prokurim.

AK ka deklaruar se: "nisur nga ato më lartë ne si AK dyshojmë se operatori ekonomik "D&T Group" shpk ka dorëzuar dokumente të falsifikuara, prandaj kërkojmë nga ju (OSHP) që ti shqyrtoni faktet tona dhe OE të lartpërmendur ta fusni në listën e zezë për prezantim të dokumenteve të falsifikuara.

Paneli shqyrtues pasi që shqyrtoj të gjitha dyshimet/ pretendimet e ngritura nga AK sqaron se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me falsifikim pasi që kemi të bëjmë me kontrata dhe dyshime për të cilat AK nuk ka ofruar prova se janë të falsifikuara por AK kanë theksuar se OE ka prezantuar kontrata që skanë të bëjnë me natyrën e punës, OE ka paraqitur referencë cila është lëshuar pas datës së mbylljes së aplikimit për këtë tender për të cilën OE ka sqaruar se kemi të bëjmë me një gabim teknik, por që të gjitha këto pretendime nuk përbëjnë bazë të mjaftueshme për ta futur OE në listën e zezë, sqaron më tej paneli shqyrtues.

Në bazë te nenit 99.2 të1 LPP-së, marrja e masave nga OSHP-ja, ndaj operatorëve ekonomik pjesëmarrës në një aktivitet te prokurimit vjen në shprehje vetëm nëse konstatohet se operatori ekonomik pjesëmarrës në një aktivitet te prokurimit ka prezantuar dokumente të falsifikuara, apo ka bërë paraqitjen e të dhënave te rreme ashtu siç parashihet me nenin 99.2. të LPP-së, andaj në rastin konkret autoriteti kontraktues në bazë te dispozitave ligjore dhe akteve nën ligjore për prokurim publik, ka të parapara masa tjera që lejohet te merren për rastin në fjalë ndaj operatorit ekonomik për te cilin ka parashtruar kërkesë në OSHP për marrjen e masave në pajtim me nenin 99.2 të LPP-së.

Paneli shqyrtues është i obliguar që të merr masa ndaj operatorëve ekonomik vetëm nëse AK-ja, ka ofruar prova ashtu siç potencohet në nenin 99 të LPP-së, në të cilin flitet për funksionet dhe kompetencat e OSHP-së, në paragrafin 2 të këtij neni, ku thuhet: *Në bazë të një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare.* Në rastin konkret AK-ja, nuk ka arritur të ofroj ndonjë dëshmi apo prove për paraqitje të dokumenteve të rreme apo të falsifikuara nga ana e OE andaj edhe kërkesa është e **pabazuar**.

Paneli shqyrtues, duke u mbështetur në nenin 99.2 të LPP-së si dhe në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – Komuna e Gjakovës
- 1x1 OE: "D&T Group" shpk
- 1x1 Arhivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ëeb- faqe të OSHP-së.